

Neni 17.7.4 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së: Shpjegim i të gjitha çështjeve që zvarritin përmbylljen e rastit të likuidimit

SFIDAT ME TË CILAT PO PËRBALLET OShP-ja dhe AKP-ja NË FINALIZIMIN E PROCESIT TË LIKUIDIMIT

• Shitja/heqja dorë e aseteve

1. Kërkesa për aktivitet të shtuar/rezultatet nga Komisioni për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik.
2. Çështjet kadastrale që janë për t'u zgjidhur përpara së të ndodh çfarëdo shitje.
3. Asetet që janë për t'u shitur nga NSh-të e mbetura që akoma nuk janë vendosur në likuidim.
4. Kanë mbetur shumë asete si varreza, rrugë, etj. që janë për t'u hequr dorë.
5. Shumë nga NSh-të e mëdha bujqësore kanë çështje eksproprijimi dhe rregullimi të tokës (komasacioni) që janë për t'u zgjidhur nga Institucionet përkatëse përpara se toka të trajtohet me përgjegjësitë e AKP-së.

• ÇËSHTJET E LIKUIDIMIT

1. Nga Agjencia ende nuk janë miratuar për likuidim NSh-të e mbetura. Është e nevojshme që NSh-të të vendosen sa më shpejt që është e mundur në likuidim, në mënyrë që AL të mund të punoj dhe finalizoj të gjitha kërkesat për këto NSh. Koha e përpunimit të këtyre kërkesave do të varet nga datat e emërimeve. Bazuar në përvojën tonë të deritanishme, pas emërimit për shqyrtim të të gjitha kërkesave të secilës NSh nevojiten rreth pesë deri në shtatë muaj.
2. Janë më shumë se 300 NSh (tashmë në likuidim ose/dhe ato që ende nuk janë miratuar për likuidim) që kanë asete të pa shitura. Në mënyrë që procesi të vazhdoj më shpejtë është e nevojshme që asetet e pa shitura të shiten sa më shpejtë që është e mundur nga AKP-ja.

• DhPGJSK

1. Shumë të ngadalshëm në përpunimin e ankesave të parashtruara kundër vendimeve të KL-ve/AL-ve. Në mënyrë të veçantë jemi të shqetësuar për kohën që do të marrë procesimi i ankesave kundër vendimeve në lidhje me kërkesat pronësore.
2. Shumë të ngadalshëm në sigurimin e konfirmimit për AL-në se nuk kanë mbetur ankesa/prendime ndaj NSh-së për të cilën janë përpunuar të gjitha kërkesat. Konfirmimi kërkohet më qëllim që AL-ja të përgatisë Raportet e Shpërndarjes Përfundimtare. Si rezultat, për shumë NSh, AL-ja po përgatit dy raporte në vend të

vetëm një (Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme dhe Përfundimtare). Raportet e Shpërndarjes Përfundimtare kërkojnë miratimin dhe pagesën tek parashtruesit përpara se të përgatiten Raportet Përfundimtare dhe të mbyllen NSh-të.

3. Shumë të ngadalshëm në zgjidhjen e masave të përkohshme.
4. Në rast se do të ketë ankesa kundër vendimeve të AL-së për NSh-të e mbetura të cilat nuk janë vendosur në likuidim, do të ketë vonesa të mëtejme në proces.

- **GJYKATAT THEMELORE**

Kemi shumë raste në gjykata për qira të papaguara si dhe për llogari të arkëtueshme (do të parashtrohen akoma edhe më shumë). Me sa duket këto raste nuk do të zgjidhen edhe për disa vjet dhe kjo do të jetë një çështje problematike kur AL nga ana e saj do të jetë gati për të mbyllur procedurat e likuidimit. Ky do të jetë një problem i veçantë për ato NSh të cilat nuk kanë fonde të mjaftueshme për të përmbushur plotësisht kërkesat e miratuara/pranuara. Për NSh-të ku fondet e disponueshme janë të mjaftueshme për të plotësuar në tërësi kërkesat e kreditorëve, fondet e disponueshme nga vendimet pozitive të Gjykatës do të shkojnë për Qeverinë. Në këto raste, tërheqja e padive apo transferimi i tyre tek Qeveria do të i mundësonte AL-së të mbyllë NSh-të.